



Republika e Kosovës
Republika e Kosovës - Republic of Kosovo

Oda e Farmacistëve të Kosovës
Kosovo Pharmacists' Association
Chamber of Pharmacists of Kosovo

No. By. No. 135 dt. 04/06/24



**ODA
E FARMACISTËVE
TË KOSOVËS**

CHAMBER OF PHARMACISTS OF KOSOVA | KOSOVO FARMACIJA KOSOVA

Për:	Të gjithë të interesuarit
Nga :	Mr.Ph. Kadri Bytyqi – Kryetar i OFK-së
Tema :	Njoftim për hyrjen në fuqi të Statutit të OFK-së
Datë:	04/06/2024



Të nderuar,

Oda e Farmacistëve të Kosovës, ka miratuar plotësim/ndryshimin e Statutit të saj duke miratuar tekstin final të statutit sipas këtyre ndryshimeve me datën 30/03/2024

Në pajtim me nenin 49, paragrafi 1 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor nr 04/L-150, Statuti i miratuar nga Kuvendi është dërguar në Ministri të Shëndetësisë për miratim me datën 16/04/2024 përmes protokollit me nr 05-2908 në MSH (shkresa e bashkangjitur në publikimin e statutit)

Edhe përkundër të kalimit të 45 ditëve nga dërgimi për miratim të Statutit, Ministria e Shëndetësisë nuk është deklaruar në afatin e paraparë prej 30 ditësh nga dërgimi i Statutit për miratim.

Andaj në pajtim me nenin 49, paragrafi 2 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor nr 04/L-150, konsiderohet ex lege se Ministria e Shëndetësisë është pajtuar me këtë statut.

Mbi këtë bazë, Oda e Farmacistëve të Kosovës pas pritjes për kalimin e të gjitha afateve ligjore, shpall hyrjen në fuqi të këtij statuti si të vlefshëm nga data 05/06/2024.



Shërbimi i Pacientit
Kamëra e Farmacistëve të Kosovës

Oda e Farmacistëve të Kosovës
Kamëra e Farmacistëve të Kosovës
Kamëra e Farmacistëve të Kosovës
Prishtinë, 16/04/2024



ODA
E FARMACISTËVE
TË KOSOVËS

CHAMBER OF PHARMACISTS OF KOSOVO (KAMËRA FARMACEUTA KOSOVA)

05-2508
16/04/2024

Për:	Z.Arben Vitia – Ministër i Shëndetësisë
Nga :	Kadri Bytyqi – Kryetar i OFK-së
Tema :	Plotësim ndryshimi i Statutit të OFK-së
Datë	16/04/2024



I nderuari Ministër Vitia,

Kuvendi i Odës së Farmacistëve të Kosovës, me datën 30/03/2024 ka mbajtur Kuvendin e saj në të cilën është bërë plotësim ndryshimi i Statutit të OFK-së. Me këto plotësim ndryshime OFK ka bërë funksionalizimin e plotës, duke përcaktuar disa procedura të cilat kërkohen me nenin 47 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor nr. 04/L-150 që të përcaktohen me dispozitat e Statutit të OFK-së si akti më i lartë juridik i brendshëm i OFK-së.

Me anë të këtyre ndryshimeve, OFK ka paraparë që Këshilli Drejtues i OFK-së të ketë kryesuesin e sajë, metodë e punës kjo e cila eliminon koncentrimin e të gjithë pushtetit vetëm te një person, Kryetari i OFK-së.

Po ashtu me ndryshimet e miratuara, kemi përcaktuar kriteret e kandidimit për organet e OFK-së duke përcaktuar njëkohësisht edhe procedurat dhe vendimarrjen për shkarkimin apo revokimin e tyre si dhe ndryshime tjera procedurale të cilat nuk prekin në përmbajtje të funksionimit të OFK-së

- Propozimet e miratuara nga Kuvendi, ishin paraprakisht në konsultim publik për periudhën 26 Shkurt – 13 Mars.

Ndryshimet e tilla kanë qenë të mirëpritura nga vetë komuniteti farmaceutik, ku nga 42 anëtarët të pranishëm si përfaqësues të farmacistëve nga të gjitha regjionet në Kuvend, propozimet u miratuan me 42 vota për.

Të bashkangjitur po ju përcjellim statutin me plotësim ndryshimet e Kuvendit.

Se bashku me këtë shkresë është dërguar statuti ku në versionin me ngjyrë të kaltër paraqiten ndryshimet, ndërsa versioni tjetër është versioni për nënshkrim ku janë të përfshira të gjitha ndryshimet.

Andaj në kuptim të nenit 49 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësor nr 04/L-150 po ju dërgojmë Statutin.



Republika e Kosovës
Republic of Kosovo

Oda e Farmacistëve të Kosovës
Kosovo Pharmacists' Association
Member of Pharmacists of Europe

No. in No. 134

01.06.2024



**ODA
E FARMACISTËVE
TË KOSOVËS**

QENDRIMET E FARMACISTËVE TË KOSOVËS (KOSOVAN PHARMACEUTICAL SOCIETY)

STATUTI I

ODËS SË FARMACISTËVE TË KOSOVËS

QERSHOR 2024

PËRMBAJTJA E STATUTIT

I DISPOZITAT E PËRGJITHSHMË	6
Neni 1	6
Qëllimi	6
Neni 2	6
Fushëveprimi	6
Neni 3	7
Atributet	7
Neni 4	7
Emërtimi dhe Sella	7
Neni 5	7
Përfaqësimi	7
Neni 6	7
Vula	7
Neni 7	7
Emblema dhe simbolet	7
II. ANËTARËSIMI NË OFK	8
Neni 8	8
Detyrimi i anëtarësimit	8
Neni 9	8
Fitimi i statusit të anëtarit	8
Neni 10	8
Të drejtat e anëtarëve të OFK-së	8
Neni 11	9
Obligimet dhe përgjegjësitë e anëtarëve të OFK-së	9
Neni 12	9
Ndërprerja e anëtarësimit	9
Neni 13	10
Obligimet e anëtarit në ndërprerjen e anëtarësimit	10
III. KOMPETENCAT E OFK	10
Neni 14	10
Kompetencat - Veprimtaritë publike të OFK-së	10
Neni 15	11
Ushtrimi i përgjegjësiave publike	11
Neni 16	11
Kompetencat tjera	11
IV. ORGANET E OFK-SË	13
Neni 17	13
Organet e OFK-së	13

Neni 18	14
Kuvendi i OFK-së	14
Neni 19	14
Papajtueshmëria e kandidimit për Kuvend të OFK-së	14
Neni 20	15
Përfundimi para kohe i mandatit të anëtarit të Kuvendit	15
Neni 21	16
Kompetencat e Kuvendit	16
Neni 22	17
Mbledhjet e Kuvendit	17
Neni 23	17
Mbarëvajtja dhe vendimmarrja e Kuvendit	17
Neni 24	18
Mbledhjet e jashtëzakonshme të Kuvendit	18
Neni 25	19
Kryetari i OFK	19
Neni 26	19
Papajtueshmëria e ushtrimit të funksionit	19
Neni 27	20
Zgjedhja e Kryetarit të OFK-së	20
Neni 28	21
Shkarkimi i Kryetarit të OFK-së	21
Neni 29	21
Procedura e shkarkimit të Kryetarit të OFK-së	21
Neni 30	22
Këshilli Drejtues	22
Neni 31	23
Përbërja e Këshillit Drejtues	23
Neni 32	23
Mbledhjet e Këshillit Drejtues	23
Neni 33	24
Këshilli mbikëqyrës i OFK-së për Buxhet dhe Financa	24
Neni 34	25
Përbërja e Këshillit Mbikëqyrës	25
Neni 35	25
Këshilli Etik	25
Neni 36	26
Masat Disiplinore	26
Neni 37	26
Afatet dhe procedura para Këshillit Etik	26

Neni 38	27
Afati i inicimit të procedurës në Gjyqin e Nderit.....	27
Neni 39	27
Përcaktimi i shkeljeve profesionale.....	27
Neni 40 Gjyqi nderit	27
Neni 41	27
E Drejta e ankesës ndaj vendimit për masë disiplinore	27
Neni 42	28
Kompetencat e Gjyqit të Nderit	28
Neni 43	28
Përbërja e Gjyqit të Nderit	28
Neni 44	28
Prokurori i OFK-së	28
Neni 45	28
Subjektet e autorizuar për inicim të procedurës disiplinore	28
Neni 46	29
Zgjedhja e Prokurorit dhe Zv. Prokurorit.....	29
Neni 47	29
Shkarkimi i anëtarëve të organeve (Këshilli Drejtues, Këshilli Etik, Gjyqi i Nderit, Prokurori i OFK-së).....	29
Neni 48	29
Komisionet e përhershme.....	29
Neni 49	30
Komisioni për Çështje Etike	30
Neni 50	30
Komisioni për licencim	30
Neni 51	31
Komisioni për Edukim Specialistik.....	31
Neni 52	31
Komisioni për Edukim të Vazhdueshëm Profesional	31
Neni 53	32
Komisioni për Praktikën Profesionale	32
Neni 54	32
Komisioni për Buxhet dhe Financa	32
Neni 55	33
Komisioni për solidaritet dhe ndihmë reciproke.....	33
Neni 56	33
Përbërja e komisioneve të përhershme të OFK-së.....	33
Neni 57	34
Komisionet e Përkohshme.....	34

Neni 58	34
V. FINANCIMI I OFK-SË	34
Neni 59	34
Të hyrat vetanake të OFK-së	34
Neni 60	34
Obligimi i anëtarëve mbi taksat administrative për shërbimet e OFK-së	34
Neni 61	35
Llogaria dhe përgjegjësia financiare	35
Neni 62	35
Fondi i solidaritetit dhe ndihmës reciproke	35
Neni 63	35
Destinimi i mjeteve nga donacionet dhe dhuratat	35
VI. TRANSPARENCA DHE MBIKËQYRJA E PUNËS	36
Neni 64	36
Transparenca e punës së OFK-së	36
Neni 65	36
Bashkëpunimi me organet tjera	36
Neni 66	36
Transparenca e mbledhjeve të organeve	36
Neni 67	37
Mbikëqyrja e punës së OFK-së	37
Neni 68	37
Miratimi i Statutit nga Ministria e Shëndetësisë	37
VII. AKTET E PËRGJITHSHME TË OFK-SË	37
Neni 69	37
Aktet e përgjithshme të OFK-së	37
VIII. SHËRBIMI ADMINISTRATIV I OFK-SË	38
Neni 70	38
Veprimtaria e shërbimit profesional	38
Neni 71	38
Organizimi i shërbimit profesional	38
IX. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE	39
Neni 72	39
Dispozita kalimtare	39
Dispozitat përfundimtare	39

KUVENDI I ODËS SË FARMACISTËVE TË KOSOVËS, në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1 dhe 4, nenit 19, paragrafi 1 me nënparagrafin 1.1 në lidhje me nenin 48 të Ligjit për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë nr. 04/L-150, në mbledhjen e mbajtur me 30/03/2024, miraton :

STATUTIN E ODËS SË FARMACISTËVE TË KOSOVËS

(Tekst i spastruar me plotësim ndryshimet e miratuar nga Kuvendi i OFK-së më datën 30/03/2024)

I DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi

1. Oda e Farmacistëve të Kosovës është Organizatë e Pavarur Profesionale e Farmacistëve që ushtrojnë veprimtarinë e tyre profesionale shëndetësore në Republikën e Kosovës.
2. Oda e Farmacistëve të Kosovës mbron dhe përfaqëson interesat profesionale të anëtarëve të saj, siguron standardet e larta të kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore, promovon dhe mbron veprimtarinë e profesionistëve shëndetësorë në institucionet shëndetësore publike dhe private, siguron edukimin e vazhdueshëm profesional në bashkëpunim me institucionet relevante arsimore dhe organizatat profesionale me qëllim të ofrimit sa më cilësor të shërbimeve farmaceutike dhe shërbimeve tjera që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor.

Neni 2

Fushëveprimi

Me këtë statut të OFK-së të Farmacistëve të Kosovës (në tekstin e mëtejshëm OFK), më për së afërmi rregullohet emërtimi, selia, organizimi i brendshëm i OFK-së, anëtarësia, kompetencat e veta, organizimi dhe funksionimi i vet, mbajtja e regjistrit të anëtarëve të vet, organet e veta, mënyra e zgjedhjes dhe revokimit të anëtarëve të OFK-së, përbërja dhe kompetencat e organeve të OFK-së, përgjegjësia disiplinore e anëtarëve të OFK-së, procedurat para Këshillit Etik dhe Gjyqit të Nderit të OFK-së, shqiptimi i masave disiplinore, burimet e financimit dhe çështjet tjera me rëndësi për punë dhe funksionim të OFK-së.

Neni 3

Atributet

1. OFK ka statusin e personit juridik me të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë të parapara me

ligjin mbi Odat e profesionistëve shëndetësorë dhe këtë statut.

2.OFK do të veprojë në emër të vet dhe do të jetë përgjegjëse për detyrimet dhe obligimet e saj, përfshirë këtu të gjitha resurset me të cilat disponon.

Neni 4 Emërtimi dhe Selia

- 1.Emërtimi i OFK-së është : **Oda e Farmacistëve të Kosovës ;**
- 2.Emërtimi i OFK-së në gjuhën angleze është: **Kosova Chamber of Pharmacists (KChP);**
- 3.Emërtimi i OFK-së në gjuhën serbe: **Komora Farmaceuta Kosova;**
- 4.Selia e OFK-së është në Prishtinë.

Neni 5 Përfaqësimi

OFK-në e përfaqëson Kryetari i OFK-së ku për çështje të caktuar mund të autorizojë apo të delegojë zv. Kryetarët apo anëtarët tjerë sipas autorizimit me shkrim.

Neni 6 Vula

- 1.OFK e ka vulën e vet të rrumbullakët dhe katrore;
2. Përmbajtja e vulave, mënyra e përdorimit dhe ruajtjes së vulës të rrumbullakët dhe asaj katrore rregullohet me akt te veçantë të OFK-së.

Neni 7 Emblema dhe simbolet

- 1.Emblema e Odës së Farmacistëve të Kosovës është simbol zyrtar i OFK-së dhe miratohet nga Kuvendi i OFK-së.
- 2.Simboli i Odës së Farmacistëve të Kosovës është i mbrojtur me ligj.

II. ANËTARËSIMI NË OFK

Neni 8

Detyrimi i anëtarësimit

1. Anëtarësimi në OFK është obligues për të gjithë farmacistët e diplomuar, të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Kosovës.
2. Anëtarësimi në OFK është obligues për të gjithë farmacistët e diplomuar të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre në kushte të mbrojtjes sociale, institucione tjera të organeve shtetërore, në fakultete, gjegjësisht në shkolla profesionale, në ambulanca të mjekësisë së punës si dhe në të gjitha rrethanat tjera ku ushtrohet veprimtaria farmaceutike shëndetësore në përputhje me ligjet në fuqi.
3. Farmacist i diplomuar është çdo person që ka mbaruar studimet themelore të Farmacisë me kohëzgjatje së paku 5 vite, përfshirë 4.5 vite kohë të plotë studimi teorik e praktik dhe një praktikë profesionale 6 mujore të kryer në një farmaci në Republikën e Kosovës.
4. Kurikula e njohurive dhe aftësive që duhet të mbulojë studimi themelor sipas paragrafit të mësipërm mbi njohjen e kualifikimeve profesionale rregullohet me akt të veçantë.

Neni 9

Fitimi i statusit të anëtarit

1. Statusi i anëtarit të OFK-së fitohet me regjistrimin në regjistrin qendror të OFK-së.
2. Për të gjithë profesionistët shëndetësor-farmacistët të cilët i plotësojnë kriteret ligjore për të qenë anëtarë të OFK-së, organet kompetente të OFK-së janë të obliguar që në afat prej 15 ditësh nga dita e paraqitjes së kërkesës të marrin vendim për regjistrimin e tyre në regjistrin zyrtar të OFK-së.
3. Ndaj vendimit nga paragrafi 2 i këtij neni mund të ushtrohet ankesë te organet kompetente në afat prej 15 ditësh nga dita e nxjerrjes së vendimit.

Neni 10

Të drejtat e anëtarëve të OFK-së

1. Anëtarët e OFK-së kanë të drejta të cilat përshijnë por nuk kufizohen në të drejtat e mëposhtme:
 - 1.1. Të ushtrojnë veprimtarinë për të cilën janë licensuar;
 - 1.2. Të japin propozime dhe iniciativa për çështje aktuale në fushën e farmacisë pranë organeve të OFK-së
 - 1.3. Të zgjedhin dhe të zgjedhen në organet e OFK-së;
 - 1.4. Të informohen për të gjitha çështjet e punës dhe veprimtarisë financiare të OFK-së;

1.5. Që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo nëpërmjet përfaqësuesve të vet të japin propozime dhe shprehin mendimin e tyre për mbrojtjen e interesave dhe integritetit personal dhe të përgjithshëm në ushtrimin e veprimtarisë profesionale farmaceutike;

1.6. Të përfitojnë ndihmë materiale fondi i veçantë i solidaritetit të OFK-së, në përputhje me kriteret dhe procedurat e parapara me akte të veçanta të OFK-së;

1.7. Të shfrytëzojnë të drejta tjera që parashihen me akte të veçanta të OFK-së.

Neni 11

Obligimet dhe përgjegjësitë e anëtarëve të OFK-së

1. Anëtarët e OFK-së kanë këto obligime dhe përgjegjësi:

1.1. Të respektojnë statutin e OFK-së, kodin e etikës profesionale dhe aktet tjera të OFK-së;

1.2. Të përmbushë obligimet mbi taksën e anëtarësimit brenda afatit të paraparë nga OFK;

1.3. Të marrin pjesë rregullisht dhe t'i kryejnë obligimet në organet e OFK-së në të cilat janë zgjedhur;

1.4. Të raportojë rregullisht për të dhënat personale që kanë të bëjnë me menaxhimin e rregullt të regjistrit të farmacistëve në afat prej 30 ditësh nga ndryshimi i tyre nga të dhënat bazë të ofruara me rastin e anëtarësimit;

1.5. Të respektojnë standardet dhe normat profesionale të shërbimit shëndetësor që në mënyrë të vazhdueshme të përfshihen në edukimin e vazhdueshëm profesional;

1.6. Të përmbushin detyrimet dhe përgjegjësitë e tjera të parapara me akte të veçanta të OFK-së.

Neni 12

Ndërprerja e anëtarësimit

1. Anëtarëve të OFK-së iu ndërpritet anëtarësimi në OFK në këto raste:

1.1. Me revokimin e përhershëm të licensës;

1.2. Në bazë të kërkesës së anëtarit të OFK-së për çregjistrim nga regjistri i anëtarëve të OFK-së;

1.3. Në rast të humbjes së zotësisë profesionale me vendim të Gjyqit të Nderit;

1.4. Në rast të mospagesës së anëtarësisë më shumë se gjashtë muaj pas afatit të pagesës, me vendim të organit i cili i regjistron anëtarët, me pasojë tërheqjen e përkohshme të licensës deri në ri-anëtarësim;

1.5. Në rast të vdekjes së anëtarit të OFK-së.

2. Farmacistët të cilëve u është ndërprerë anëtarësimi për shkak të mospërbushjes së takses administrative mbi anëtarësim, mund të rianëtarësohet sërish, pas përmbushjes së detyrimeve në përputhje me aktin e veçantë të Kuvendit të OFK-së.

Neni 13

Obligimet e anëtarit në ndërprerjen e anëtarësimit

Anëtarit të OFK-së që i është ndërprerë anëtarësia është i obliguar që në afat prej 7 ditësh të dorëzojë OFK-së kartelën e anëtarësimit dhe vulën personale. Ndaj anëtarit të cilit nuk respektojnë detyrimet e përcaktuara me këtë nen, fillohet procedura pranë Këshillit Etik për shkeljen e legjislacionit.

III. KOMPETENCAT E OFK

Neni 14

Kompetencat - Veprimtaritë publike të OFK-së

1. Kompetencat publike të OFK-së janë:

- 1.1. Miratimi i kodit të etikës profesionale (Kodi Etik);

- 1.2. Regjistrimi dhe mirëmbajtja e regjistrit të profesionistëve, bashkëpunëtorëve shëndetësorë dhe institucioneve relevante shëndetësore;

- 1.3. Lëshimi i licensave, ri-licensimi dhe revokimi i tyre;

- 1.4. Zbatimi i mbikëqyrjes profesionale me angazhim të ekspertëve të fushave përkatëse;

- 1.5. Bashkëpunimi me institucionet publike qendrore dhe lokale që merren me çështjet e shëndetësisë dhe bashkëpunimi me shoqatat e tjera profesionale në vend dhe jashtë vendit;

- 1.6. Ushtrimi i mbikëqyrjes profesionale dhe ligjore mbi punën e profesionistëve shëndetësorë;

- 1.7. Planifikimi dhe zbatimi i edukimit të vazhdueshëm profesional;

- 1.8. Ndërmjetësimi në kontekstet në mes anëtarëve të OFK-së dhe shfrytëzuesve të shërbimeve shëndetësore;

1.9. Organizimi i Gjyqit të Nderit për përcaktimin e shkeljeve dhe obligimeve profesionale të anëtarëve të OFK-së dhe shqiptimi i masave disiplinore;

1.10. Përcakton vlerën e pagesës vjetore të anëtarësisë;

1.11. Përcakton lartësinë e taksës për licensim, ri-licensim, dhe lejeve tjera për ushtrim të veprimtarisë profesionale në bazë të autorizimeve ligjore;

1.12. Lëshon kartelat e identifikimit, vulat personale dhe numrat identifikues për anëtarët e OFK-së;

1.13. Me kërkesën e anëtarëve të OFK-së lëshon certifikata, vërtetime dhe dokumente tjera në bazë të evidencës zyrtare të OFK-së.

Neni 15

Ushtrimi i përgjegjësiwe publike

Përgjegjësitë publike, organet e OFK-së i ushtrojnë sipas procedurës së paraparë me ligjin mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative .

Neni 16

Kompetencat tjera

1. Përfaqëson dhe mbrohet interesat profesionale të anëtarëve të OFK-së në ushtrimin e profesionit;
2. Kujdeset për ruajtjen e autoritetit të anëtarëve të OFK-së në ushtrimin e veprimtarisë profesionale në pajtim me etikën profesionale;
3. Mban evidencën e anëtarëve të OFK-së që ushtrojnë veprimtarinë private shëndetësore dhe të cilët janë të regjistruar në regjistrin e organit kompetent në pajtim me ligjin;
4. Bashkëpunon në përgatitjen e ligjeve, dokumenteve si dhe akteve tjera nënligjore në sektorin e shëndetësisë si dhe mbikëqyrja e zbatimit të tyre;
5. Jep mendim profesional dhe merr pjesë në përgatitjen e ligjeve, akteve nënligjore dhe rregulloreve që në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë lidhen me fushën e farmacisë;
6. Propozon dhe inicion nxjerrjen e akteve të përgjithshme dhe të veçanta në përputhje me Ligjin, Statutin dhe aktet tjera të OFK-së;

7. Përcakton çmimoren për shërbimet shëndetësore farmaceutike, në bashkëpunim me institucionin shtetëror përgjegjës për sigurime shëndetësore dhe shfrytëzuesit e shërbimeve shëndetësore;
8. Përcakton çmimet e produkteve mjekësore në bashkëpunim me institucionet tjera përgjegjëse;
9. Përpilon programin për edukim të vazhdueshëm profesional për të gjithë profesionistët shëndetësorë që ushtrojnë veprimtarinë e tyre në fushën e farmacisë;
10. Ndërmerr aktivitete shkencore dhe hulumtuese në përputhje me detyrat dhe përgjegjësitë e OFK-së;
11. Përfaqëson interesat profesionale dhe sociale të profesionistëve shëndetësorë dhe bashkëpunëtorëve tjerë;
12. Këshillon, ofron asistencë dhe përfaqëson interesat e anëtarëve të OFK-së në fushën e legjislacionit dhe fushat tjera që ndërlidhen me fushën e shëndetësisë;
13. Përfaqëson interesat e anëtarëve të saj në lidhjen e kontratave me institucionin shtetëror përgjegjës për sigurime shëndetësore dhe institucione tjera të sigurimeve shëndetësore;
14. Propozon metodën e përcaktimit të çmimit të shitjes me pakicë të produkteve mjekësore dhe produkteve tjera që nuk janë subjekt i kontratës me institucionin shtetëror përgjegjës për sigurime shëndetësore;
15. Merr pjesë dhe propozon metodën e përcaktimit të çmimit produkteve mjekësore dhe produkteve tjera që janë subjekt i kontratës me institucionin shtetëror përgjegjës për sigurime shëndetësore;
16. Mbikëqyr përcaktimin e çmimeve për produktet mjekësore dhe produktet tjera që janë subjekt i kontratës me sigurimet vullnetare shëndetësore;
17. Merr pjesë në hartimin e listës së barnave për rimbursim, listës esenciale të barnave dhe programeve për mbrojtje të shëndetit publik;
18. Ofron asistencë ligjore për anëtarët e saj;
19. Rregullon marrëdhëniet në mes të anëtarëve të saj dhe merr pjesë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të mundshme;
20. Mbron dhe promovon reputacionin e farmacistit dhe farmacisë, si dhe reagon në deklaratat e padrejta dhe të pa baza të cilat eventualisht mund të transmetohen në çfarëdo mediumi publik;
21. Me qëllim të mbrojtjes së shëndetit të pacientëve përcakton normat dhe standardet e shërbimit farmaceutik;
22. Themelon dhe menaxhon buxhetin e OFK-së;
23. Bashkëpunon me organet përkatëse në parandalimin e veprimtarisë ilegale farmaceutike;
24. Bën botimin e revistave dhe librave profesionale si dhe publikimeve tjera;

25. Promovon dhe organizon ngjarje kulturore, sportive dhe ngjarje të tjera sociale;
26. Emëron përfaqësuesit e OFK-së në marrëveshje me institucionet e të gjitha niveleve të kujdesit shëndetësor;
27. Në përputhje me ligjin përmes të deleguarëve në komisione, borde dhe grupe tjera punuese qeveritare jep rekomandime për aktet legislative përkatëse që nxirren nga Ministritë përgjegjëse;
28. Ushtron mbikqyrjen e funksionimit ligjor të shërbimeve shëndetësorë në institucionet nga neni 35 (burgjet), 36 (policia), 37 (përkujdesi social), 38 (shoqëria civile) i Ligjit për Shëndetësi
28. Zbaton aktivitete tjera në përputhje me ligjin, statutin dhe aktet tjera të përgjithshme të OFK-së.

IV. ORGANET E OFK-SË

Neni 17

Organet e OFK-së

1. Organet e OFK-së janë:

- 1.1. Kuvendi;
- 1.2. Kryetari i OFK-së
- 1.3. Këshilli Drejtues
- 1.4. Këshilli mbikëqyrës i OFK-së;
- 1.5. Këshilli Etik;
- 1.6. Gjyqi i Nderit;
- 1.7. Prokurori i OFK-së;
- 1.8. Komisionet e përhershme të OFK-së.

1.9. Komisionet e përhershme të OFK-së janë :

- 1.9.1. Komisioni për çështje etike;
- 1.9.2. Komisioni për licensim;
- 1.9.3. Komisioni për edukim specialistik;
- 1.9.4. Komisioni për edukim të vazhdueshëm profesional;
- 1.9.5. Komisioni për praktikën profesionale;
- 1.9.6. Komisioni për buxhet dhe financa;
- 1.9.7. Komisioni i solidaritetit dhe ndihmës reciproke.

2. Mandati i anëtarëve të organeve të OFK-së është 4 vite. Anëtarët e organeve vazhdojnë ushtrimin e detyrës deri në konstituimin e organeve të reja të dalura nga zhedhjet me përjashtim

të rasteve të shkarkimit të anëtarit

3. Lartësia e taksave për shpenzimet materiale të OFK-së si dhe lartësinë e mëditjeve për punë të anëtarëve të OFK-së përcaktohet me akt të veçantë normative të OFK-së të aprovuar nga Kuvendi i OFK-së.

4. Mënyra e zgjedhjes dhe revokimit të anëtarëve të organeve të OFK-së përcaktohet me këtë statut dhe me rregullore të veçantë mbi zgjedhjen dhe shkarkimin e anëtarëve të organeve të OFK-së.

Neni 18 **Kuvendi i OFK-së**

1. Kuvendi është organi më i lartë i OFK-së i cili ushtron të gjitha të drejtat dhe përgjegjësitë të parapara me ligj dhe këtë statut.

2. Kuvendi i OFK-së përbëhet nga 59 anëtarë me mandat 4-vjeçar. Anëtarët e Kuvendit nuk mund të ushtrojnë radhazi më shumë se dy mandate.

3. Anëtarët e Kuvendit zgjedhen sipas kriterit përfaqësues, një anëtar i Kuvendit për çdo (në anëtarëve të përgjithshëm të regjistruar/ 59) anëtarë të regjistruar.

4. Anëtarët e Kuvendit të OFK-së zgjedhen me votim të drejtpërdrejtë dhe të fshehtë të përcaktuara nga Komisioni Qendror Zgjedhor i OFK-së në përputhje me këtë statut, të cilët zgjedhen në shtatë regjionet e Kosovës.

5. Secili nga regjionet funksionon si një njësi e vetme zgjedhore në regjion (01. Prishtinë, 02.Mitrovicë, 03.Pejë, 04.Prizren, 05.Perizaj, 06 Gjilan dhe 07. Gjakovë) sipas ndarjes administrative.

6. Çështjet tjera procedurale nga ky nen rregullohen me akt të veçantë të Kuvendit.

Neni 19 **Papajtueshmëria e kandidimit për Kuvend të OFK-së**

1. Për anëtarë të Kuvendit të OFK-së nuk mund të kandidojnë anëtarët të cilët :

- 1.1. Janë të dënuar me vendim të formës së prerë me tërheqje të përkohshme të licensës prej të paktën 3 viteve, gjatë 5 viteve të fundit.
- 1.2. Janë të dënuar me aktgjykim të formës së prerë kundër detyrës zyrtare dhe shëndetit publik.

Neni 20 **Përfundimi para kohe i mandatit të anëtarit të Kuvendit**

1. Mandati i anëtarit të Kuvendit të OFK-së përfundon para kohe, kur :

- 1.1. Nuk jep betimin brenda dy takimeve të njëpasnjëshme të Kuvendit pas certifikimit si anëtar i Kuvendit;
 - 1.2. Jep dorëheqje;
 - 1.3. Përfundon mandati i Kuvendit;
 - 1.4. Me humbjen e statutsit të anëtarit të OFK-së;
 - 1.5. Mungon në tri takime radhazi pa arsye dhe pa njoftim paraprak të Kryetarit të OFK-së;
 - 1.6. Dënohet me aktgjykim të formës së prerë për vepër penale me një ose më shumë vjet burgim;
 - 1.7. Ajo/ai vdes;
 - 1.8. Nëse organet etike me vendim të formës së prerë tërheqin licensën e anëtarit për periudhë, jo më pak se 3 vite;
 - 1.9. Në rast të revokimit të mandatit të tij nga njësia zgjedhore me iniciimin e 1/3 të anëtarëve të njësisë përkatëse, sipas procedurës të përcaktuar me rregulloren për zgjedhjen dhe shkarkimin e anëtarëve të organeve të OFK-së;
 - 1.9.1. Mandati i anëtarit të Kuvendit revokohet nëse për revokim kanë votuar $\frac{1}{2} + 1$ e anëtarëve të njësisë përkatëse zgjedhore.
2. Me iniciimin e 1/4 së anëtarëve të përgjithshëm të OFK-së në kohën e inicimit, mund të fillohet procedura për deklarim të mosbesimit përkatësisht shpërbërjen e tërësishme të Kuvendit të OFK-së.
3. Mocioni është i sukseshëm nëse për propozimin për shpërbërje kanë votuar $\frac{1}{2} + 1$ e anëtarëve të përgjithshëm të OFK-së.
4. Procedura e realizimit të këtij procesi përcaktohet me rregulloren mbi zgjedhjen dhe shkarkimin e anëtarëve të organeve të OFK-së.
5. Me rastin e përfundimit të mandatit të anëtarit të Kuvendit para kohe, anëtarit i pushojnë të gjitha funksionet të cilat i ushtron brenda organeve të OFK-së të cilat zgjedhen nga Kuvendi
6. Procedura e zëvendësimit të anëtarit të Kuvendit të OFK-së të cilat përfundojnë mandatin para kohe përcaktohet me rregulloren për zgjedhjen dhe shkarkimin e anëtarëve të organeve të OFK-së.

Neni 21

Kompetencat e Kuvendit

1. Kuvendi është organi më i lartë i OFK-së, i cili ka këto përgjegjësi dhe autorizime :
 - 1.1. Miraton, ndryshon dhe plotëson statutin dhe aktet e tjera normative;
 - 1.2. Miraton kodin e etikës profesionale;
 - 1.3. Miraton programin e punës së OFK-së;
 - 1.4. Miraton rregulloret e punës të organeve të OFK-së;
 - 1.5. Miraton planin buxhetor vjetor të OFK-së;
 - 1.6. Zgjedh dhe shkarkon Kryetarin e OFK-së;
 - 1.7. Zgjedh dhe shkarkon anëtarët e këshillit drejtues të OFK-së;
 - 1.8. Zgjedh dhe shkarkon Kryetarin, zv. kryetarin dhe anëtarët e Këshillit Etik;
 - 1.9. Zgjedh dhe shkarkon Kryetarin dhe anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës;
 - 1.10. Zgjedh dhe shkarkon Kryetarin dhe anëtarët e Gjyqit të Nderit;
 - 1.11. Zgjedh dhe shkarkon Prokurorin e OFK-së;
 - 1.12. Zgjedh dhe shkarkon kryetarin dhe anëtarët e komisioneve të përhershme të OFK-së;
 - 1.13. Përcakton vlerën e pagesës vjetore të anëtarësisë për anëtarët e OFK-së;
 - 1.14. Përcakton vlerën e pagesës për anëtarësim për anëtarët e OFK-së, taksën për licensim dhe ri-licensim si dhe lartësinë e taksës për lëshimin e certifikatave, vërtetimeve dhe dokumenteve tjera për të cilat Oda mban evidencë zyrtare;
 - 1.15. Vendosi për vlerën e mjeteve të ndara për fondin e OFK-së për ndihmë reciproke të anëtarëve të OFK-së .
 - 1.16. Shqyrton dhe miraton raportet e punës së organeve të OFK-së;
 - 1.17. Miraton raportin vjetor të OFK-së;
 - 1.18. Miraton raportin financiar dhe llogarinë përfundimtare të OFK-së;
 - 1.19. Miraton raportin mbi punën e Këshillit Drejtues të OFK-së;
 - 1.20. Merr vendim për shkarkim të Kuvendit të OFK-së dhe shpall zgjedhjet e parakohshme;
 - 1.21. Vendosi për anëtarësim të OFK-së në Organizatat Ndërkombëtare si motra, merr vendime për ndarjen e mirënjohjeve dhe shpërblimeve të OFK-së;

1.22. Shqyrton dhe merr qëndrime parimore për çështjet me rëndësi për punën e OFK-së.

2. Vendimet e Kuvendit nga fushëveprimi i tij janë përfundimtare dhe të ekzekutueshme brenda OFK-së. Të njëjtat mund të atakohen vetëm në procedurën e Konfliktit Administrativ pranë gjykatës kompetente.

Neni 22

Mbledhjet e Kuvendit

1. Mbledhjet e Kuvendit të OFK-së janë të hapura për publikun;
2. Kuvendi mund të vendosë që mbledhja të jetë e mbyllur për publikun e gjerë (duke përjashtuar këtu anëtarët e OFK-së) kur ka të bëjë me çështje konfidenciale, të ndjeshme për interesin e farmacistëve;
3. Mbledhjet e Kuvendit të OFK-së mbahen sipas nevojës, e më së paku dy herë në vit;
4. Mbledhjet e Kuvendit të OFK-së i udhëheq kryetari i OFK-së;
5. Votimi për pikat e rendit të ditës është i hapur përveç në raste kur Kuvendi vendos ndryshe;
6. Mbledhjet e Kuvendit mund të mbahen nëse janë të pranishëm më shumë se gjysma e anëtarëve nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Kuvendit të OFK-së;
7. Kuvendi i merr vendimet me shumicën e thjeshtë të anëtarëve të pranishëm, përpos në rastet kur me këtë statut përcaktohet ndryshe;
8. Statuti i OFK-së dhe ndryshimet/plotësimet e tij mund të miratohen me votimin e 2/3 të anëtarëve nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të OFK-së;

Neni 23

Mbarëvajtja dhe vendimmarrja e Kuvendit

Me rregulloren mbi punën e Kuvendit të OFK-së në mënyrë më të përafërt përcaktohen çështjet tjera të cilat nuk rregullohen më këtë statut, çështje si: mënyrat e thirrjes së mbledhjeve të Kuvendit, e udhëheqjes së mbledhjes së Kuvendit dhe mënyra e marrjes së vendimeve, dhe çështje tjera procedurale dhe teknike për mbarevajtjen e mbledhjeve të Kuvendit.

Neni 24

Mbledhjet e jashtëzakonshme të Kuvendit

1. Me kërkesë të Këshillit drejtues, ose me kërkesë të 1/4 të anëtarëve të kuvendit të OFK-së, kryetari i OFK-së është i obliguar të thërras mbledhjen e jashtëzakonshme të Kuvendit e cila duhet të mbahet në afat prej 15 ditësh nga dita pranimi të propozimit;

1.1. Ftesa nga Kryetari i OFK-së me të cilin përcaktohet data dhe orari i mbajtjes së takimit të Kuvendit dërgohet brenda 3 ditë nga pranimi i kërkesës.

2. Në rast të pamundësisë së kryetarit, mbledhjen e Kuvendit e thërret njëri nga zv. kryetarët e OFK-së, Kryetari i Këshillit Drejtues apo anëtarët parashtrues të kërkesës sipas radhës së moshës .

2.1. Pamundësi apo refuzimi në kuptim të këtij paragrafi nënkupton mosdërgimin e ftesës nga subjekti i autorizuar sipas radhës të anëtarët e Kuvendit brenda 3 ditëve nga pranimi i kërkesës nga inicuesit për mbledhje të jashtëzakonshme.

3. Në rast se ftesa për mbledhjen e Kuvendit ku përcaktohet data dhe orari i mbledhjes së jashtëzakonshme nuk dërgohet të anëtarët e Kuvendit së paku 48 orë para arritjes së ditës së 15 nga pranimi i kërkesës, konsiderohet se parashtruesit kanë hequr dorë nga kërkesa për mbledhje të jashtëzakonshme.

4. Propozimi nga paragrafi 1 i këtij neni duhet të formulohet me shkrim së bashku me materialin e rendit të ditës. Rendi i ditës nuk mund të pësojë ndryshime nga rendi i propozuar dhe dorëzuar me kërkesë. Rendi ditës nuk i nënshtrohet aprovimit në Kuvend, por sipas statuti është rend dite i asaj mbledhjeje.

5. Në rast refuzimi për drejtimin e mbledhjes të jashtëzakonshme nga Kryetari dhe Zv. Kryetari, e drejta e drejtimit të mbledhjes kalon në subjektin tjetër të autorizuar sipas këtij neni.

5.1. Refuzim në kuptim të këtij paragrafi nënkupton mosdrejtimin e seancës apo mosprezencën e Kryetarit apo zv. Kryetarit në takim për kohëzgjatje prej jo më pak se 20 min nga orari i përcaktuar për fillimin e takimit.

6. Në rast se brenda 3 orësh nga orari i përcaktuar për mbajtjen e takimit, asnjë nga anëtarët sipas radhës së përcaktuar nga paragrafet paraprak nuk pranojnë ta udhëheqin mbledhjen, konsiderohet se mbledhja ka përfunduar.

7. Çështjet tjera procedurale nga ky nen rregullohen me akt të vecantë të Kuvendit.

Neni 25 **Kryetari i OFK**

1. Detyrat dhe përgjegjësitë e kryetarit të OFK-së:

- 1.1. Përfaqëson Odën dhe vepron në emër të saj;
- 1.2. Fton dhe udhëheq seancat e Kuvendit;
- 1.3. Ushtron të gjitha kompetencat, të cilat nuk i jepen në mënyrë eksplicite Kuvendit të OFK-së
- 1.4. Ekzekuton aktet e Kuvendit të OFK-së;
- 1.5. I propozon Kuvendit të OFK-së emërimin dhe shkarkimin e zëvendësve të tij/saj;
- 1.6. Organizon punën dhe drejton politikën e OFK-së;
- 1.7. Propozon rregullore apo akte të tjera për miratim në kuvendin OFK-së;
- 1.8. Raporton para Kuvendit të OFK-së për situatën ekonomiko-financiare të OFK-së, së paku njëherë në vit apo kurdoherë që kërkohet nga kuvendi i OFK-së;
- 1.9. Në rast mungese, kryetarin e OFK-së e zëvendëson njëri nga zv. kryetarët e OFK-së, të cilin e autorizon Kryetari i OFK-së me shkrim. Zv. kryetarët mund ta ushtrojnë këtë funksion jo më shumë se 6 muaj.
- 1.10. Në rast se Kryetari i OFK-së nuk kthehet në funksionin e tij për 6 muaj, Kuvendi i OFK-së shpall zgjedhjet për Kryetarin e ri apo zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e OFK-së të cilat organizohet jo më larg se 45 ditë nga kalimi i afatit 6-mujor.
 - 1.10.1. Zgjedhjet e përgjithshme për Kuvendin e OFK-së, nga ky paragraf shpallen me votat e 2/3 të anëtarëve të Kuvendit.
- 1.11. Jep deklarata për shtyp ose e autorizon ndonjë person tjetër;
- 1.12. Për punën e vet i përgjigjet Kuvendit të OFK-së;
- 1.13. Kryen aktivitetet tjera që i caktohen me këtë statut dhe akte të përgjithshme të OFK-së;

Neni 26 **Papajtueshmëria e ushtrimit të funksionit**

Kryetari i OFK-së, zëvendës Kryetarët, anëtarët e Këshillit Drejtues dhe Sekretari i Përgjithshëm nuk mund të jenë persona të zgjedhur dhe të emëruar në funksione tjera publike dhe politike, përveç profesionale mjekësore dhe në mësimdhënie.

Neni 27
Zgjedhja e Kryetarit të OFK-së

1. Kryetarin e OFK-së e zgjedh Kuvendi i OFK-së në bazë të rregullores për zgjedhje dhe shkarkimin e anëtarëve të organeve të OFK-së.
2. Çdo kandidat për kryetar të OFK-së duhet të mbështetet prej së paku 10 anëtarëve të kuvendit të OFK-së;
3. Çdo kandidat për kryetar të OFK-së para mbajtjes së votimit në kuvend prezanton, përvojën, vizionin dhe objektivat për mandatin në të cilin kandidon në kohëzgjatje prej jo më shumë se 10 minuta;
4. Çdo kandidat për kryetar të OFK-së duhet të nënshkruajë deklaratën për konflikt të interesit.
5. Kryetari i OFK-së duhet të jetë Farmacist i diplomuar – licensuar dhe të plotësojë këto kushte:
 - 5.1. Të ketë së paku 5 vjet përvojë pune në fushën e farmacisë,
 - 5.2. Të mos jetë i dënuar për shkelje të kodit etik dhe për vepër penale;
6. Votimi për Kryetar të OFK-së, zhvillohet si votim i fshehtë edhe në rastet kur për këtë funksion ka kandiduar vetëm një anëtar;
7. Kryetari i OFK-së zgjedhet kandidati i cili në roundin e parë të votimit merr gjysmën e votave të anëtarëve të përgjithshëm të Kuvendit.
 - 7.1. Në rast se asnjëri nga kandidatët nuk arrinë numrin e mjaftueshëm për t'u zgjedhur në roundin e parë, zhvillohet roundi i dytë mes dy kandidatëve më të votuar në roundin e parë. Në raundin e dytë, Kryetar i OFK-së zgjedhet kandidati i cili ka marrë gjysmën e votave të anëtarëve të pranishëm të Kuvendit.
 - 7.2. Nëse edhe pas roundit të dytë nuk zgjedhet Kryetari i OFK-së, përsëritja e votimit bëhet në afat prej jo më larg se 10 ditësh nga dështimi i roundit të dytë.
 - 7.3. Nëse edhe pas përsëritjes së raundit të dytë asnjëri nga dy kandidatët nuk arrijnë të marrë gjysmën e votave të anëtarëve të pranishëm, Kuvendi i OFK-së shpërndahet dhe organizohen zgjedhjet e reja për Kuvend.
 - 7.4. Zgjedhjet mbahen brenda 45 ditësh nga dita e dështimit të këtij roundi. Data e zgjedhjeve vendoset nga KQZ.
8. Në rast të dështimit të seancës për zgjedhjen e Kryetarit të OFK-së, OFK-në deri në zgjedhjen e Kryetarit të ri e udhëheq anëtari më i vjetër i Kuvendi sipas radhës së moshës, në funksion

të Kryetarit në Detyrë.

9. Afati i ushtrimit të funksionit të Kryetarit në Detyrë fillon nga data e dështimit të seancës për zgjedhjen e kryetarit të OFK-së.
10. Mandati i Kryetarit të OFK-së është 4 vite, dhe angazhimi i tij në OFK paraqet punë primare.

Neni 28

Shkarkimi i Kryetarit të OFK-së

1. Kuvendi i OFK-së mund të shkarkojë Kryetarin e OFK-së para përfundimit të mandatit nëse:

1.1. Shkel statutin, rregulloret dhe aktet e përgjithshme të OFK-së apo nuk i zbaton vendimet e Kuvendit të OFK-së dhe vepron në kundërshtim me ato;

1.2. Mocioni mosbesim (pakënaqshmërisë me efektivitetin e punës së Kryetarit)

2. Kryetari i OFK-së shkarkohet me votën e $\frac{1}{2}$ të anëtarëve të përgjithshëm të Kuvendit.

Neni 29

Procedura e shkarkimit të Kryetarit të OFK-së

1. Procedura për shkarkimin e Kryetarit të OFK-së, fillon me dorëzimin e propozimit për shkarkim të nënshkruar nga $\frac{1}{4}$ të anëtarëve të përgjithshëm të Kuvendit, së bashku me arsyetim përkatës. Kërkesa i dorëzohet Kryetarit të OFK-së duke kërkuar thirrjen e seancës së Kuvendit për votim të mocionit.

1.1. Ftesa e Kuvendit dhe drejtimi i mbledhjes për shkarkimin e kryetarit të OFK-së rregullohet përshtatshmërisht me rregullat për ftesën e Kuvendit të Jashtëzakonshëm.

2. Në seancën mbi shqyrtimin e propozimit për shkarkim të Kryetarit, fillimisht paraqitet propozimi për shkarkim nga njëri prej propozuesve të kërkesës dhe pastaj Kryetari i OFK-së prezanton kundërshtimin e tij, pas së cilit zhvillohet procesi i votimit të fshehtë për shkarkimin e Kryetarit.

3. Në rast se propozimi për shkarkim nuk miratohet nga Kuvendi, një propozim tjetër për shkarkim mund të parashtrohet jo më herët se 90 ditë nga dështimi i votimit të propozimit për shkarkim. Mocioni për të njëjtën arsyetim për të cilën ka dështuar mocioni paraprak nuk mund të paraqitet sërish përjashtimisht rasteve për arsye të mosbesimit.

4. Nëse propozimi i shkarkimit me mocion miratohet nga $\frac{1}{2}$ e anëtarëve të përgjithshëm të Kuvendit, detyrën e Kryetarit të OFK-së e ushtron zv. Kryetari i parë i OFK-së në cilësinë e Kryetarit në detyrë.

- 4.1 Detyra e Kryetarit të OFK-së në cilësi të Kryetarit në detyrë mund të ushtrohet sipas

radhës nga zv. Kryetari i parë, Zv. Kryetari i dytë, Kryetari i Këshillit Drejtues, Anëtar i më i vjetër i Kuvendit të OFK-së i cili emëron për zv. Kryetar, anëtarin më të ri të Kuvendit. Kalimi i radhës për ushtrim detyre të kryetarit nga njëri subjekt i përcaktuar me këtë paragraf, në subjekt tjetër bëhet vetëm në rast pamundësi apo refuzimi të subjektit paraardhës për ta ushtruar funksionin.

4.2. Me termin pamundësi apo refuzim i ushtrimit të funksionit të Kryetarit në detyrë në kuptim të këtij neni, kuptohet situata e mos ushtrimit të funksionit brenda 5 ditëve nga dita e nesërme e ngjarjes nga ku pozita e Kryetarit apo Kryetarit në detyrë ka mbetur e lirë.

5. Në rast se brenda periudhës 6 mujore nga ku është votuar propozimi për shkarkimin e Kryetarit të OFK-së, nuk arrin të zgjidhet Kryetari i ri i OFK-së, Kuvendi i OFK-së shpërmdahet sipas statutit. Zgjedhjet e reja shpallen nga KQZ jo më vonë se 45 ditë nga skadimi i afatit prej 6 muaj për zgjedhjen e Kryetarit të OFK-së.

Neni 30

Këshilli Drejtues

1. Këshilli Drejtues është organ i OFK-së i përbërë nga 11 anëtarë që ushtron përgjegjësi dhe kompetencat të parapara me ligj, këtë statut dhe aktet tjera normative të OFK-së;
2. Këshilli drejtues i OFK-së:
 - 2.1. Është përgjegjës për zbatimin e vendimeve të kuvendit të OFK-së;
 - 2.2. Propozon statutin dhe akte tjera të OFK-së;
 - 2.3. Propozon Kuvendit anëtarë të organeve të OFK-së;
 - 2.4. Përcjell dhe harmonizon punën e organeve të OFK-së;
 - 2.5. Harton dhe i propozon Kuvendit programin e punës së OFK-së;
 - 2.6. Mbikëqyrë zbatimin e programit të punës së OFK-së;
 - 2.7. Propozon te organet shtetërore masat për mbrojtjen dhe përparimin e mbrojtjes shëndetësore dhe sigurimit shëndetësor;
 - 2.8. Harton dhe i propozon kuvendit planin buxhetor vjetor të OFK-së dhe kujdeset për zbatimin e tij;
 - 2.9. Miraton llogaritë periodike financiare;
 - 2.10. Emëron dhe shkarkon sekretarin e përgjithshëm të OFK-së;
 - 2.11. Punëson dhe shkarkon punonjësit e shërbimit profesional të OFK-së;

- 2.12. Harton rregulloren e punës së këshillit drejtues;
- 2.13. Shqyrton dhe miraton raportet periodike të punës së OFK-së në fushat për të cilat është përgjegjëse;
- 2.14. Miraton rregulloren mbi organizimin dhe sistematizimin e punëve të shërbimit profesional të OFK-së dhe merr masa për sigurimin e ligjshmërisë dhe efikasitetin e punës të shërbimit profesional;
- 2.15. Vendosi në shkallë të dytë sipas ankesave nga marrëdhënia e punës të punëtorëve të shërbimit profesional të OFK-së;
- 2.16. Miraton komisionet funksionale dhe grupe punuese për çështjet me rëndësi për funksionimin dhe ushtrimin e kompetencave të Këshillit Drejtues dhe organeve tjera kolegjiale, të cilat si të tilla nuk janë përcaktuar për asnjë nga organet kolegjiale nga Kuvendi i OFK-së.
- 2.17. Kryen dhe punë tjera të parapara me këtë statut dhe akte tjera të OFK-së.

Neni 31

Përbërja e Këshillit Drejtues

1. Këshilli drejtues i OFK-së ka njëmbëdhjetë (11) anëtarë dhe udhëhiqet nga kryetari i Këshillit Drejtues;
2. Kryetari dhe zv. kryetarët e OFK-së janë anëtarë të këshillit drejtues sipas detyrës zyrtare;
3. Anëtarët tjerë të këshillit drejtues i zgjedh Kuvendi nga radha e anëtarëve të vet;
4. Ministria delegon tre (3) anëtarë në këshillin drejtues, duke përfshirë një anëtarë nga komuniteti jo shumicë dhe një anëtarë nga komunitetet tjera;
5. Sekretari i Përgjithshëm i OFK-së është person i ftuar gjithmonë në takimet e Këshillit drejtues pa të drejtë vote;
6. Sekretari i Përgjithshëm i OFK-së mund të propozojë pika në rendin e ditës dhe dokumente mbështetëse të tyre.

Neni 32

Mbledhjet e Këshillit Drejtues

1. Këshilli Drejtues merr vendime me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm të Këshillit Drejtues.

2. Mandati i anëtarëve të Këshillit Drejtues zgjat katër vite dhe përputhet me mandatin e anëtarëve të kuvendit.
3. Mbledhjet e Këshillit Drejtues i udhëheq Kryetari i Këshillit Drejtues.
4. Pikat e rendit të ditës të mbledhjes së Këshillit Drejtues dhe materialet lidhur me të i përgatitë Kryetari i Këshilli Drejtues në koordinim me Kryetarin e OFK-së.
5. Këshilli drejtues mban mbledhje të rregullta së paku njëherë në muaj. Në rast se Kryetari apo zv. Kryetari i Këshillit Drejtues të OFK-së nuk fiton takim brenda muajit, takimi i Këshillit Drejtues mund të mbahet me ftesën e Kryetarit të OFK-së apo edhe të anëtarit më të vjetër të Këshillit Drejtues.
6. Mbledhjet e këshillit drejtues janë të hapura për anëtarët e OFK-së, sipas procedurës së rregulluar me akt të veçantë.
7. Në mungesë të kryetarit të Këshillit Drejtues OFK-së, mbledhjet e Këshillit Drejtues i udhëheq Zv. Kryetari i Këshillit Drejtues, Kryetari i OFK-së apo njëri nga anëtarët e Këshillit Drejtues.
8. Kryetari dhe zv. Kryetar i Këshillit Drejtues zgjedhjet nga Këshilli Drejtues me shumicë të votave.
 - 8.1. Kandidatura për Kryetar dhe zv. Kryetar të Këshillit Drejtues mund të paraqitet vetëm nga pesë anëtarët e Këshillit Drejtues të Zgjedhur nga Kuvendi i OFK-së.
9. Anëtarët e Këshillit Drejtues nuk mund të ushtrojnë funksione tjera brenda organeve kolegjiale dhe komisioneve të përhershme të OFK-së.
10. Këshilli Drejtues për punën e vet i përgjigjet Kuvendit të OFK-së.
11. Puna e Këshillit Drejtues përcaktohet me rregulloren e punës së Këshillit Drejtues.
12. Këshilli Drejtues paraqet raport me shkrim Kuvendit për punën e tij së paku dy herë në vit.

Neni 33

Këshilli mbikëqyrës i OFK-së për Buxhet dhe Financa

1. Mbikëqyrë dhe përcjellë veprimtarinë financiare të organeve të OFK-së;
2. Mbikëqyrë ligjshmërinë e vendimeve me impakt financiar të organeve të OFK-së;
3. Përcjellë dhe mbikëqyrë realizimin e të drejtave dhe obligimeve të anëtarëve të OFK-së

të cilat kanë implikime financiare;

4. Mbikëqyrë dhe përcjellë punën e shërbimit profesional të OFK-së;
5. Propozon këshillit drejtues marrjen e masave dhe veprimeve në rastet financiare kur vlerëson se ka shkelje ligjore dhe të akteve tjera të miratuara nga Kuvendi i OFK-së;
6. Ndërmerr aktivitete tjera mbikëqyrëse financiare me kërkesë të Kryetarit të OFK-së, Këshillit Drejtues apo së paku të 10 anëtarëve të Kuvendit të OFK-së.
7. Kryen dhe punë tjera të parapara me statut dhe me akte tjera të OFK-së.

Neni 34

Përbërja e Këshillit Mbikëqyrës

1. Këshilli mbikëqyrës i OFK-së përbëhet nga shtatë (7) anëtarë, dy nga të cilët i delegon Ministria e Shëndetësisë.
2. Kryetarin, zv. kryetarin dhe anëtarët e tjerë të këshillit i zgjedh kuvendi nga radha e anëtarëve të vetë, në pajtim me rregulloren për zgjedhje dhe revokim të anëtarëve dhe organeve të OFK-së.
3. Këshilli mbikëqyrës i OFK-së për punën e vet i përgjigjet kuvendit të OFK-së.

Neni 35

Këshilli Etik

Këshilli Etik:

1. Mbikëqyr zbatimin e Kodit të Etikës dhe Deontologjisë;
2. Siguron udhëheqjen etike-morale e deontologjike dhe promovon parimet e etikës profesionale;
3. Merr masat e duhura në rast të shkeljes së Kodit etik dhe të Deontologjisë;
4. Pranon dhe shqyrton ankesat nga ana e qytetarëve;
5. Jep mendim dhe vlerësim për punën e anëtarëve të OFK-së në pajtim me kodin e etikës profesionale;
6. I ofron mbështetje qytetarëve në realizimin e së drejtës së cilësisë së shërbimeve, llojit dhe përmbajtjes së shërbimeve;

7. Kryen dhe punë tjera të parapara me statut të OFK-së si dhe me akte të veçanta të OFK-së.
8. Këshilli Etik ka pesë anëtarë.
9. Kryetarin, zëvendës-kryetarin dhe tre anëtarët e tjerë të Këshillit Etik i zgjedh kuvendi nga radha e anëtarëve të OFK-së, në pajtim me rregulloren mbi procedurën e kandidimit dhe mënyrën e zgjedhjes dhe revokimit të anëtarëve të OFK-së dhe organeve tjera. Një anëtar e propozon MSH-së.

Neni 36 **Masat Disiplinore**

1. Këshilli Etik është organ i shkallës së parë, i cili fillon procedurën për përcaktimin e përgjegjësisë të profesionistëve shëndetësorë për shkelje të këtij ligji, statutit të OFK-së dhe kodit etik dhe varësisht nga shkeljet e konstatuara shqipton këto masa disiplinore:
 - 1.1. Rekomandim kolegjal;
 - 1.2. Kërkim falje ndaj pacientit;
 - 1.3. Qortim ose qortim publik,
 - 1.4. Arsimim shtesë dhe të detyrueshëm pasuniversitar dhe trajnim;
 - 1.5. Trajtimi i detyrueshëm nga alkooli, droga dhe vese të tjera;
 - 1.6. Tërheqja e përkohshme ose e përhershme e licencës dhe fshirja e profesionistit shëndetësor nga regjistri i OFK-së;
 - 1.7. Kompensimin e dëmit të pacientit kur është e aplikueshme ;
 - 1.8. Dënim i me të holla deri në 3000 euro për çdo shkelje të ligjit, detyrave profesionale dhe etike.

Neni 37 **Afatet dhe procedura para Këshillit Etik**

1. Në procedurë para Këshillit Etik të OFK-së zbatohen dispozitat dhe rregullat e procedurës së përgjithshme administrative të ligjit mbi procedurë penale, mbi sigurimin e provave, procesverbalin, dëgjimin e palës dhe procedurave tjera.
2. Anëtar i OFK-së ndaj të cilit është filluar procedura disiplinore doemos duhet t'i mundësohet deklarimi dhe mbrojtja pranë Këshillit Etik.

3. Në procedure e marrjes në pyetje të anëtarëve të OFK-së dhe vlerësimit të provave në procedure disiplinore para Këshillit Etik mbahet procesverbali.
4. Procedura pranë Këshillit Etik, nuk mund të fillojë në rast se kanë kaluar më shumë se 9 muaj nga shkelja e supozuar profesionale e anëtarit të OFK-së. Në këto raste, me vendim refuzues Këshilli Etik mbyll procedurë.
5. Këshilli Etik pas pranimit të ankesës brenda 60 ditësh nxjerrë vendimin meritator për ankesën.
6. Sipas ankesës ndaj vendimit të këshillit etikë vendos Gjyqi i Nderit.
7. Deri në nxjerrjen e vendimit përfundimtar, pala e cila është në procedurë është e pafajshme dhe i gëzon të gjitha të drejtat e përcaktuara me Statutin dhe aktet e OFK-së.

Neni 38

Afati i inicimit të procedurës në Gjyqin e Nderit

Fillimi i procedurës para Gjyqit të Nderit për përcaktimin e shkeljeve të anëtarit të OFK-së nga neni 36, pika 4,5,6,7,8 nuk mund të fillojë pas skadimit të një viti nga dita e shkeljes profesionale dhe shkeljes së nderit të anëtarit të OFK-së.

Neni 39

Përcaktimi i shkeljeve profesionale

Kriteret më të përafërta për përcaktimin e shkeljeve, procedurën për përcaktimin e përgjegjësisve të farmacistëve për shkeljet e këtij statuti dhe kodit të etikës mjekësore përcaktohen me akt të veçantë të OFK-së.

Neni 40

Gjyqi nderit

1. Gjyqi i Nderit i OFK-së është organ i OFK-së që ushtron funksionet e përcaktuara me ligj, me këtë statut dhe aktet tjera normative të OFK-së.
2. Gjyqi i Nderit ushtron funksionin e vetë në mënyrë të pavarur dhe duke u bazuar në ligjin mbi odat mjekësore, këtë statut dhe aktet tjera normative të OFK-së.

Neni 41

E Drejta e ankesës ndaj vendimit për masë disiplinore

Ndaj vendimit përfundimtar me të cilën është shqiptuar masa disiplinore nga neni 36 pika 4,5,6,7 dhe 8 i këtij statuti farmacistët mund të ushtrojnë ankesë pranë Gjykatës së Nderit të profesionistëve shëndetësorë.

Neni 42

Kompetencat e Gjyqit të Nderit

1. Gjyqi i Nderit vendos edhe lidhur me ankesat e anëtarëve të OFK-së, dhe parregullsive në procesin e zgjedhjeve të organeve të OFK-së.
2. Gjyqi i Nderit trajton ankesat e anëtarëve në afat prej 15 ditësh ndaj vendimeve të cilat mund të cenojnë të drejtat e tyre në kuadër të:
 - 2.1. Vendimeve të KQZ-së të nxjerra ndaj vendimmarrjes të KNJZ-ve në proceset zgjedhore.
 - 2.2. Vendimeve të KQZ-së të nxjerra në procedurën e certifikimit të kandidatëve për zgjedhjen në organet e OFK-së.
 - 2.3. Kundër vendimeve të organeve të cilat kanë vendosur në ankesë në shkallë të parë, përjashtimisht vendimet e Kuvendit të OFK-së të cilat atakohen vetëm në procedurën e konfliktit administrativ.

Neni 43

Përbërja e Gjyqit të Nderit

1. Gjyqi i Nderit ka pesë anëtarë, Kryetarin, zëvendësin e tij dhe tre anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi i OFK-së, në pajtim me rregulloren mbi procedurën e kandidimit dhe mënyrën e zgjedhjes dhe revokimit të anëtarëve të OFK-së dhe organeve tjera.
2. Një anëtarë dhe zëvendësin e tij e propozon Këshilli Gjyqësorë i Kosovës.

Neni 44

Prokurori i OFK-së

Prokurori i OFK-së është organ i pavarur për iniciimin e procedurës ndaj anëtarëve të OFK-së ndaj të cilëve ekziston dyshimi i bazuar se ka bërë shkelje të ligjit, statutit dhe kodit të etikës mjekësore në aspektin e shkeljes profesionale farmaceutike,

Neni 45

Subjektet e autorizuara për iniciim të procedurës disiplinore

Inicimi i procedurës mund të bëhet edhe me kërkesë nga Ministria e Shëndetësisë, Shoqata e Farmacistëve, Shoqatat e Profesionistëve Shëndetësorë, Institucionet Shëndetësore, Fondi i Sigurimeve Shëndetësore, Prokuroria Shtetërore, anëtarët e OFK-së dhe pala e dëmtuar.

Neni 46

Zgjedhja e Prokurorit dhe Zv. Prokurorit

1. Prokurorin edhe zëvendësin e tij e zgjedh Kuvendi i OFK-së nga radha e anëtarëve të OFK-së, në pajtim me rregulloren mbi procedurën e kandidimit dhe mënyrën e zgjedhjes dhe revokimit të anëtarëve të OFK-së dhe organeve tjera.
2. Prokurori i OFK-së për punën e vet i përgjigjet Kuvendit të OFK-së.

Neni 47

Shkarkimi i anëtarëve të organeve (Këshilli Drejtues, Këshilli Etik, Gjyqi i Nderit, Prokurori i OFK-së)

1. Procedura e shkarkimi të anëtarit të organeve inicohet me kërkesën e Kryesuesit të atij organi/komisioni të OFK-së, $\frac{1}{2}$ e anëtarëve të organit përkatës apo me iniciativën e $\frac{1}{4}$ e anëtarëve të Kuvendit të OFK-së për shkak të mosefikasitetit apo pengimit të punës së organit.
2. Anëtar i organit të OFK-së shkarkohet nëse për këtë kanë votuar shumica e anëtarëve të përgjithshëm të Kuvendit të OFK-së.
3. Për shkarkimin Kryetarit apo zv. Kryetarit të Këshillit Drejtues vendos Këshilli Drejtues.
4. Për shkarkimin e Prokurorit të OFK-së iniciimi bëhet nga $\frac{1}{4}$ e anëtarëve të Kuvendit të OFK-së.
5. Mandati i Kryetarit apo zv. Kryetarit të Këshillit Drejtues është revokuar nëse për të kanë votuar $\frac{1}{2}$ e anëtarëve të përgjithshëm të Këshillit Drejtues.

Neni 48

Komisionet e përhershme

1. OFK ka komisionet e përhershme dhe të përkohshme. Anëtarët e komisioneve të OFK-së i zgjedh Kuvendi nga radha e anëtarëve të OFK-së, në pajtim me rregulloren për zgjedhje dhe shkarkimin e anëtarëve të organeve të OFK-së.
2. Komisionet e përhershme të OFK-së janë :
 - 2.1. Komisioni për Çështje etike;
 - 2.2. Komisioni për Licensim;
 - 2.3. Komisioni për Edukim specialistik;
 - 2.4. Komisioni për Edukim të vazhdueshëm profesional;

- 2.5. Komisioni për Praktikën private profesionale;
- 2.6. Komisioni për Buxhet dhe Financa;
- 2.7. Komisioni i solidaritetit dhe ndihmës reciproke.

Neni 49 **Komisioni për Çështje Etike**

- 1. Komisioni për Çështje Etike ka këto kompetenca dhe përgjegjësi :
 - 1.1.Mbikëqyrë zbatimin e hulumtimeve shkencore – profesionale;
 - 1.2.Inicon propozime mbi plotësim ndryshimin e Kodit Etike të OFK-së;
 - 1.3.Promovon parimet e Kodit Etik përmes ruajtjes dhe përkrahjes së besimit në mesin e farmacistëve, profesionistëve tjerë shëndetësor dhe pacientëve;
 - 1.4.Edukimin etik përmes sigurimit të cilësisë së veprimtarisë mjekësore;
 - 1.5.Çështje tjera që i besohen Komisionit në bazë të akteve normative të OFK-së.

Neni 50 **Komisioni për licencim**

- 1. Komisioni për licencim ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
 - 1.1. Përpilimin e rregullores për lëshimin, vazhdimin dhe revokimin e licensës së anëtarëve të OFK-së;
 - 1.2. Regjistrimin, licensimin dhe rilicensimin e farmacistëve të diplomuar në bazë të kriterëve për edukim dhe kualifikim profesional të përcaktuar me aktet e OFK-së dhe legjislacionin përkatës;
 - 1.3. Me kërkesë të Këshillit Etik revokon dhe kufizon licensën për veprimtari farmaceutike;
 - 1.4. Organizon provimin profesional për licensim të magjistrave të farmacisë në bashkëpunim me Fakultetin e Farmacisë të Universitetit të Prishtinës;
 - 1.5. Bashkëpunon me komisionin për edukim të vazhdueshëm profesional;
 - 1.6. Fshin sipas detyrës nga regjistri anëtarët të cilët nuk përfillin afatet kohore për realizimin e taksës për anëtarësim, duke revokuar përkohësisht licensat deri në rianëtarësimin e tyre;
 - 1.7. Njohja e licensave të lëshuara jashtë Republikës së Kosovës për farmacist me shtetësi Kosovare;

1.8. Kryen detyra tjera në përputhje me këtë statut dhe aktet tjera të OFK-së.

Neni 51

Komisioni për Edukim Specialistik

1. Komisioni për edukim specialistik ka këto kompetenca dhe përgjegjësi :

- 1.1. Përkufizimi i objektivave dhe misionit të edukimit specialistik
- 1.2. Përpilimi i draft planit dhe programit të shkollimit specialistik dhe sub-specialistik në pajtim me rregulloren për edukim specialistik dhe dispozitat ligjore në fuqi
- 1.3. Analizimi dhe vlerësimi i punës praktike, teorike dhe rezultateve të specializantëve
- 1.4. Bashkëpunimi me universitetet vendore dhe ndërkombëtare për organizimin dhe realizimin e edukimit specialistik
- 1.5. Përcaktimi i fushave priorare të specializimit bazuar në nevojat e vendit tonë
- 1.6. Përcaktimi i metodave të përshtatshme të shkollimit specialistik
- 1.7. Hartimi i rregullores për edukim specialistik
- 1.8. Kryen detyra tjera në përputhje me këtë statut dhe aktet tjera të OFK-së
- 1.9. Bashkëpunon me fakultetin e farmacisë të Universitetit të Prishtinës në kryerjen e të gjitha detyrave të mësipërme.
- 1.10. Kryen detyrat tjera në përputhje me këtë statut dhe aktet tjera të OFK

Neni 52

Komisioni për Edukim të Vazhdueshëm Profesional

1. Komisioni për Edukim të Vazhdueshëm Profesional ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

- 1.1. Përpilon planin dhe programin për edukim të vazhdueshëm profesional;
- 1.2. Përpilon rregulloren për edukim të vazhdueshëm profesional;
- 1.3. Përcakton pikët kredituese për kurset dhe format tjera të edukimit të vazhdueshëm;
- 1.4. Vlerëson me pikë kredituese kurset dhe format tjera të edukimit të vazhdueshëm;
- 1.5. Zhvillon sistemin për evidentim të edukimit të vazhdueshëm profesional;
- 1.6. Bashkëpunon ngushtë me komisionin për licensim;
- 1.7. Akrediton planet-programet e shoqatave profesionale për edukim të vazhdueshëm profesional;
8. Rekomandon mbështetje financiare për shoqatat profesionale për realizimin e programeve të edukimit të vazhdueshëm në përputhje me mundësitë buxhetore;
- 1.9. Kryen detyra tjera në përputhje me këtë statut dhe aktet tjera të OFK-së.

Neni 53
Komisioni për Praktikën Profesionale

1. Komisioni për praktikën profesionale ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

- 1.1. Përpilon udhëzuesin për praktikën e mirë të farmacistë;
- 1.2. Përcakton plan-programin për stazhin e praktikës profesionale për farmacistë; praktikant në bashkëpunim me Fakultetin e Farmacisë të Universitetit të Prishtinës;
- 1.3. Përcakton kriteret të cilat duhet t'i plotësojnë farmacistë dhe institucionet tjera shëndetësore në të cilat mund të kryhet stazhi i praktikës profesionale;
- 1.4. Përpilon librezat e stazhit të praktikës profesionale;
- 1.5. Përcakton përmbajtjen, metodat dhe procedurat mbajtjes së provimit profesional në bashkëpunim me Fakultetin e Farmacisë të Universitetit të Prishtinës;
- 1.6. Kryen detyra tjera në përputhje me këtë statut dhe aktet tjera të OFK-së;

Neni 54
Komisioni për Buxhet dhe Financa

1. Komisioni për Buxhet dhe Financa përbëhet nga dy nënkomisione:

1.1. Nënkomisioni për çështje buxhetore të OFK-së;

1.2. Nënkomisioni për çështje farmako-ekonomike.

2. **Nënkomisioni për çështje buxhetore** ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

- 2.1. Harton dhe propozon Këshillit Drejtues planin buxhetor vjetor të OFK-së;
- 2.2. Harton dhe propozon Këshillit Drejtues rregulloren për politikën dhe procedurat financiare të OFK-së;
- 2.3. Këshillon kryetarin dhe Këshillin Drejtues të OFK-së lidhur me veprimtarinë financiare të OFK-së.
- 2.4. Kryen detyra tjera në përputhje me këtë statut dhe aktet tjera të OFK-së.

3. **Nënkomisioni për çështje farmako-ekonomike** ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

- 3.1. Propozon metodën e përcaktimit të çmimit produkteve mjekësore dhe produkteve tjera që janë subjekt i kontratës me institucionin shtetëror përgjegjës për sigurime shëndetësore;
- 3.2. Propozon metodën e përcaktimit të çmimit të shitjes me pakicë të produkteve mjekësore dhe produkteve tjera që nuk janë subjekt i kontratës me institucionin shtetëror përgjegjës për sigurime shëndetësore;

3.3. Përcakton çmimoren e shërbimeve farmaceutike;

3.4. Mbikëqyrë përcaktimin e çmimeve për produktet mjekësore dhe produktet tjera që janë subjekt i kontratës me sigurimet vullnetare shëndetësore;

3.5. Kryen detyra tjera në përputhje me këtë statut dhe aktet tjera të OFK-së;

3.6. Anëtarët e këtij nënkomisioni nuk mund të jenë apo të kenë qenë të punësuar së paku në 12 muajt fundit në asnjë kompani apo përfaqësues të ndonjë kompanie që merret me prodhimin, importimin, shpërndarjen dhe shitjen me shumicë të produkteve apo pajisjeve mjekësore/farmaceutike.

Neni 55

Komisioni për solidaritet dhe ndihmë reciproke

1. Komisioni për solidaritet dhe ndihmë reciproke ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:
 - 1.1. Përcakton kriteret për përfitimin e fondit të solidaritetit;
 - 1.2. Në bashkëpunim me Këshillin Drejtues përcakton shumën e buxhetit që i dedikohet fondit të solidaritetit;
 - 1.3. Përpilon formularët për aplikim për përfitim të ndihmës financiare;
 - 1.4. Kryen detyra tjera në përputhje me këtë statut dhe aktet tjera të OFK-së.

Neni 56

Përbërja e komisioneve të përhershme të OFK-së

1. Komisionet e përhershme të OFK-së përbëhen nga 5 anëtarë nga radhët e të cilëve zgjedhet Kryesuesi dhe zv. Kryesuesi i Komisionit .
2. Anëtarët e komisioneve të përhershme të OFK-së mund të jenë anëtarë të vetëm një komisioni të përhershëm.
3. Mbledhjet e Komisioneve të Përhershme i fton dhe udhëheq kryetari i komisionit.
4. Komisionet e përhershme së paku 1 herë në vit raportojnë për punën e tyre Këshillit Drejtues dhe Kuvendit të OFK-së, apo organit të përcaktuar me rregullore të veçantë.

Neni 57

Komisionet e Përkohshme

1. Në OFK funksionojnë komisionet e përkohshme si:
 - 1.1. Komisioni për farmaci në institucionet shëndetësore (barantore komunitare, institucionet parësore, dytësore dhe tretësore).
 - 1.2. Komisioni për Farmaci në institucionet tjera joshëndetësore (MSH, AKPPM, FSSH, ISH-IF, Institucione arsimore të arsimit të lartë akredituar për farmaci dhe tjera).
2. Propozimi i përbërjes së komisioneve nga paragrafi I-rë bëhet nga Këshilli Drejtues dhe nuk mund të kenë më shumë se 7 anëtarë. Në përbërjen e komisioneve nga ky nen, nuk mund të ketë më shumë se 1 anëtar nga e njëjti institucion.
3. Fushëveprimi i tyre këshillimorë dhe propozues për Këshillin Drejtues përcaktohet me akt të veçantë të Kuvendit.

Neni 58

Përbërja dhe fushëveprimi i komisionit nga neni 48 dhe 57 i këtij statuti përcaktohen me statutin e OFK-së dhe aktet e veçanta normative.

V. FINANCIMI I OFK-SË

Neni 59

Të hyrat vetanake të OFK-së

1. Oda e Farmacistëve e Kosovës realizon të hyra vetanake nga:
 - 1.1. Anëtarësia;
 - 1.2. Kompensimi (taksës) për anëtarët e OFK-së, taksën për licensim dhe rilicensim si dhe lartësinë e taksës për lëshimin e certifikatave, vërtetimeve dhe dokumenteve tjera për të cilat OFK mban evidencë zyrtare;
 - 1.3. Dhuratat dhe donacionet e tjera si dhe të hyrat tjera në pajtim me ligjin.

Neni 60

Obligimi i anëtarëve mbi taksat administrative për shërbimet e OFK-së

1. Anëtarët e OFK-së kanë obligim që në mënyrë të rregullt të paguajnë anëtarësinë vjetore, licensim dhe shërbime të tjera administrative në pajtim me ligjin dhe aktet tjera normative të OFK-së.

2. Në rast dështimi të përmbushjes së këtyre obligimeve organet e OFK-së marrin masa disiplinore ndaj anëtarëve të saj.
3. Me akt të veçantë të OFK-së do të përcaktohet lartësia e kompensimit (taksës) për anëtarët e OFK-së, taksës për licensim dhe ri-licensim si dhe e taksës për lëshimin e certifikatave, vërtetimeve dhe dokumenteve tjera për të cilat OFK mban evidencë zyrtare.

Neni 61

Llogaria dhe përgjegjësia financiare

1. Mjetet e OFK-së udhëhiqen në xhirollogarinë e OFK-së.
2. Kryetari i OFK-së është përgjegjës financiar i OFK-së.
3. OFK është përgjegjëse për punën e saj dhe tërë pasurinë që disponon.
4. Menaxhimi financiar i OFK-së rregullohet me akt të veçantë të Kuvendit në përputhje me këtë Statut.

Neni 62

Fondi i solidaritetit dhe ndihmës reciproke

1. OFK hap llogari të veçantë, menaxhon mjetet e dedikuara në fondin e solidaritetit dhe ndihmës reciproke të anëtarëve të OFK-së.
2. Mjetet nga paragrafi 1 i këtij neni mund të përdoren për ofrimin e ndihmës së drejtpërdrejtë të anëtarëve të OFK-së, dhe të anëtarëve të familjes së tyre në rast fatkeqësie, për sigurim të OFK-së të bartësve të sigurimit të pasurisë të personave në rast të lëshimeve profesionale si dhe aftësimin e vazhdueshëm profesional të anëtarëve të OFK-së në pajtim me këtë ligj dhe statutin dhe aktet e tjera të OFK-së.
3. Fondi i solidaritetit përcaktohet në vartësi nga kapaciteti financiar i OFK-së dhe nuk mund të jetë nën shumën prej 3000 euro për vit.

Neni 63

Destinimi i mjeteve nga donacionet dhe dhuratat

Mjetet nga donacionet dhe dhuratat nuk mund të shfrytëzohen për mbulimin e shpenzimeve të OFK-së përveç në rastet që shprehimisht janë të destinuara për këtë qëllim apo rastet e EVP-së dhe solidaritetit.

VI. TRANSPARENCA DHE MBIKËQYRJA E PUNËS

Neni 64

Transparenca e punës së OFK-së

1. OFK obligohet që të njoftojnë opinionin mbi çështjet e rëndësishme nga fushëveprimi i OFK-së.
2. OFK ka për obligim të njoftojë organet kompetente të ndjekjes, organet kompetente gjyqësore dhe Ministrinë përgjegjëse për shëndetësi për procedurën disiplinore që udhëhiqet ndaj anëtarëve të OFK-së nga organet e OFK-së si dhe procedurën e licensimit, ri-licensimit dhe revokimit të licensës nëse dyshohet se në këto procedura ekziston dyshimi i bazuar që është kryer vepër penale.
3. OFK ka për obligim që me kërkesë të organeve nga paragrafi 2 i këtij neni t'i vë në dispozitim të gjitha faktet dhe informatat që posedon.

Neni 65

Bashkëpunimi me organet tjera

OFK bashkëpunon me institucionet arsimore të profilit shëndetësor, institucionet shëndetësore, shoqatat e profesionistëve shëndetësorë, fondet e sigurimeve shëndetësore lidhur me çështjet e rëndësishme për punët e OFK-së dhe të mbrojtjes shëndetësore të qytetarëve.

Neni 66

Transparenca e mbledhjeve të organeve

1. Mbledhjet e Kuvendit dhe organeve tjera të OFK-së janë të hapura për opinion.
2. Kuvendi i OFK-së apo organi tjetër i OFK-së mund të vendosë për përjashtimin e opinionit nga i tërë takimi apo nga një pjesë e tij në rastet kur takimi i hapur kërcënon të zbulojë informacione të cilat janë të klasifikuara si të besueshme sipas ligjit mbi qasjen në dokumentet zyrtare, si dhe informacione të ndjeshme personale apo komerciale.
3. Njoftimet për takimin e Kuvendit bëhen publike.
4. Me rregulloren të veçantë parashihet procedura e njoftimeve publike për takimet e Kuvendit dhe organeve tjera.

Neni 67
Mbikëqyrja e punës së OFK-së

1. Mbikëqyrjen ndaj ligjshmërisë së punës së OFK-së në ushtrimin e funksioneve publike nga neni 9 i ligjit mbi odat e profesionistëve shëndetësorë e bën Ministria e Shëndetësisë.
2. Në ushtrimin e mbikëqyrjes nga pika 1 e këtij neni, Ministria për Shëndetësi mund të kërkojë nga organet e OFK-së raport dhe informata për çështje të caktuara.
3. OFK është e obliguar që raportet dhe informatat nga pika 2 e këtij neni t'i ofrojë Ministrisë Shëndetësisë në afat prej 30 ditësh nga dita e kërkesës, ose të informojë për arsyet për të cilat nuk është e mundur të dërgojë brenda afatit të kërkuar.
4. OFK është e obliguar që gjerë në 31 mars të vitit vijues të dërgojnë Ministrisë së Shëndetësisë raportin vjetor për vitin paraprak.
5. OFK është e obliguar që t'i nënshtrohet auditimit të pavarur të jashtëm çdo 2 vjet, së paku 2 herë gjatë një mandati.

Neni 68
Miratimi i Statutit nga Ministria e Shëndetësisë

1. Ministria e Shëndetësisë e jep pëlqimin në statutin e OFK-së në pjesën që kanë të bëjnë me autorizimet publike të OFK-së nga neni 9 ligjit mbi Odat e Profesionistëve Shëndetësorë.
2. Në rast se Ministria e Shëndetësisë nuk deklарohet në afat prej 30 ditësh për projekt-statutin, konsiderohet se është pajtuar me këtë statut.

VII. AKTET E PËRGJITHSHME TË OFK-SË

Neni 69
Aktet e përgjithshme të OFK-së

1. Aktet e përgjithshme të OFK-së janë statuti, kodi i etikës profesionale, rregulloret e ndryshme, udhëzimet dhe vendimet e tjera të organeve të OFK-së të cilat kanë të bëjnë me çështje të përgjithshme të anëtarëve.
2. Aktet e përgjithshme të OFK-së duhet të jenë në pajtim me Kushtetutën, ligjin dhe këtë statut.
3. Iniciativën për nxjerrje dhe ndryshim të akteve të përgjithshme të OFK-së mund ta marrin organet e OFK-së, sipas procedurës të përcaktuar me rregullore të veçantë.

4. Miratimit të akteve të përgjithshme të OFK-së duhet t'i paraprijë debati publik, me komunitetin farmaceutik, forma e realizimit të debatit publik përcaktohet me rregullore të veçantë.

VIII. SHËRBIMI ADMINISTRATIV I OFK-SË

Neni 70

Veprimtaria e shërbimit profesional

1. Zyra Administrative ushtron veprimtarinë e mëposhtme:

- 1.1. Ushtrimin e detyrave administrative dhe profesionale

- 1.2. Regjistrimin, licensimin dhe autorizimin e profesionistëve shëndetësorë dhe bashkëpunëtorëve shëndetësorë e që nuk janë anëtarë të Odave sipas vendimit nga organi kompetent;

- 1.3. Mbajtjen e regjistrit të profesionistëve shëndetësorë sipas vendimit nga organi kompetent;

- 1.4. Aktivitete të tjera që Oda mund t'i delegojë Zyrës Administrative;

- 1.5. Ushtron edhe detyra tjera administrative nga neni 8 dhe 9 i ligjit mbi odat e profesionistëve shëndetësorë;

2. Detyrat nga paragrafi paraprak kryhen në bazë të kontratës për shërbime ndërmjet OFK-së dhe zyrtarit të Zyrës Administrative

Neni 71

Organizimi i shërbimit profesional

1. Organizimi dhe puna e zyrës administrative përcaktohet me akt të veçantë për organizimin dhe sistematizimin e punëve të miratuar nga Këshilli Drejtues i OFK-së.
2. Të punësuarit në zyrën administrative të OFK-së i gëzojnë të gjitha të drejtat dhe obligimet të përcaktuara me ligjin e punës, këtë statut dhe aktet tjera të OFK-së.
3. Punën e zyrës administrative e udhëheqë sekretari i përgjithshëm i OFK-së.
4. Sekretari i përgjithshëm kryen detyrat që ia përcakton Oda.
5. Sekretari i përgjithshëm zgjidhet nga Këshilli Drejtues në bazë të konkursit publik.

IX. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 72

Dispozita kalimtare

1. Organet të cilat janë krijuar në përbërja aktuale e Kuvendit, vazhdojnë së funksionuari deri në fund të mandatit të rregullt.
2. Brenda periudhës 6 -mujore nga hyrja në fuqi e këtij statuti, grupet punuese të emëruara nga Këshilli Drejtues propozojnë harmonizimin e akteve nënligjore të OFK-së me statutin.

Neni 73

Dispozitat përfundimtare

1. Çështjet procedurale në zbatim të dispozitave të këtij statuti, rregullohen me akt të veçantë.
2. Termat dhe procedurat e përcaktuara në këtë statut për organet e OFK-së, do të zbatohen përshtatshmërisht për të gjitha organet për të cilat nuk janë rregulluar procedura të veçanta.
3. Zbrazëtitat juridike të cilat mund të krijohen dhe nuk janë të parapara me këtë Statut apo me akte të veçanta, interpretohen nga Këshilli Drejtues në përputhje me rregullimin e odave tjera.
4. Me hyrjen në fuqi të këtij Statutit shfuqizohet dispozitat e akteve juridike të OFK-së të cilat janë në kundërshtim me dispozitat e këtij Statuti.
5. Ky Statut hyn në fuqi 7 ditë pas nënshkrimit të Ministrit të Shëndetësisë, apo pas kalimit të afatit për deklarim të Ministrisë.

Kryetari i OFK-së
Mr.Ph. Kadri Bytyqi



Datë 04/06/2024